



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:063460
Datë: 13.11.2023
Numri i dokumentit: 04909384

PPP.nr.463/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit K “I”, me seli në P, Rruga “G.Z”, numër ..., ndaj debitorit B.S, me vendbanim në P, Lagjja “T”, Rruga “A.K”, A.G, L..., lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.3457/18 të datës 28.12.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat R.M në P, jashtë seancës gjyqësore, me datë 10.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit B.S nga P, ashtu që: SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e Përmbartimit P.nr.3457/2018 i datës 28.12.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat R.M në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat R.M nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K “I”, me seli në P, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 3457/2018 i datës 28.12.2018 me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të vendimit nr..., të datës ..., me të cilin urdhër ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh, nga data e dorëzimit të Urdhrit t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 2,037.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim, me pretendimin se i njëjti i është nënshtruar disa provimeve, mirëpo nuk ka pasur mundësi të paguajë dhe as të vijojë studimet në këtë drejtim, duke kërkuar nga kreditori çregjistrimin e tij. Tutje ka shtuar se vendimi administrativ, gjegjësisht dokumenti përmbartues, nuk mund të jetë titull ekzekutiv për shkak se nuk është lidhur

një marrëveshje për përcaktimin e detyrimeve reciproke. Në fund ka kërkuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Përgjigje në prapsim ka paraqitur kreditori, duke theksuar se kreditori është i licencuar dhe akredituar nga autoritetet publike, rrjedhimisht edhe vendimi i lëshuar nga kreditori, sipas të njëjtit konsiderohet vendim administrativ. Tutje ka theksuar se debitori ka filluar 3 vite akademike të studimeve, pasi që i njëjti është nënshtruar 19 herë provimeve në universitet, me ç'rast e ka paguar shumën prej vetëm 263.00 euro, ndërsa detyrimi i mbetur konsiston në shumë prej 2,037.00 euro, dhe pagesa e fundit e debitorit e bërë në këtë aspekt, është ekzekutuar me datë 01.08.2014. Krejt në fund ka theksuar se prapësimi është i pa bazuar për shkak se nuk është i mbështetur në asnjë provë relevante, dhe i njëjti nuk e përmbushë asnjë shkak ligjor nga neni 71 i LPP-së. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pathemeltë, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për arsytet në vijim:

Dispozita nga neni 22 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcakton llojet e dokumenteve përmbaruese (titujve ekzekutiv), mbi bazën e të cilave organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin në kuptim të nenit 21 të LPP-së. Kjo dispozitë parasheh që: *“Dokumente përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese; 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia); 9 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.”*

Në rastin konkret, organi përmbarues e ka lejuar përmbarimin bazuar në vendimin nr..., të dt..., të lëshuar nga ana e kreditorit, e që ka të bëjë me regjistrimin e studentit në vitin akademik. Gjykata vlerëson se një dokument i tillë nuk bën pjesë në ndonjërin prej kategorive të dokumenteve përmbarimore, të numëruara me dispozitën e lartëcekur nga neni 22 e LPP-së, dhe si i tillë nuk i përmbushë kriteret e kërkuara për të shërbyer si dokument mbi bazën e të cilit mund të lejohet dhe caktohet përmbarimi.

Gjykata mori parasysh pretendimin e ngritur nga ana e kreditorit në përgjigje në prapësim se i njëjti është i licencuar dhe akredituar nga autoritetet publike, rrjedhimisht edhe vendimi i lëshuar nga ana e të njëjtit konsiderohet vendim administrativ. Interpretimi i Gjykatës konsiston në faktin

se licencimi apo akreditimi për të ushtruar një veprimtari të caktuar nga ana e një autoriteti publik, nuk ia jep subjektit – në rastin konkret kreditorit cilësinë apo kompetencat e një organi administrativ. Rrjedhimisht, edhe vendimet e lëshuara nga ana e këtyre subjekteve nuk e kanë cilësinë e vendimeve të dhëna në procedurë administrative, në kuptim të dispozitës nga neni 22 pika 1.2 të LPP-së. Nisur nga rrethanat e tilla, pretendimi i palës kreditore lidhur me përmbarueshmërinë e dokumentit është pa mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi.

Dispozita nga neni 43 par.4 e LPP-së përcakton se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*. Mbi këtë bazë, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përmbarimit nga përmbaruesi privat, sepse është lejuar përmbarimi mbi bazën e një dokumenti i cili rezulton se nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor (titullit ekzekutiv), andaj duke iu referuar dispozitës së lartëcekur, gjeti se pretendimet e parashtruara në prapësimin e debitorit janë të bazuara, rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e shfuqizuar Urdhërin për lejimin e Përmbarimit.

Mbi bazën e arsyeve të elaboruara më sipër, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil-
PPP.nr.463/2019 datë 10.11.2023

Gj y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.